

dhuna në  
familje

qështje  
jete

UDHËRRËFYES PËR MBROJTJEN  
E VIKTIMAVE TË DHUNËS  
NË FAMILJE



UDHËRRËFYES PËR MBROJTJEN  
E VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE

Prishtinë, 2011



Përgatitur nga :

Mr. sc. Ramadan Gashi, trajnues gjyqësor në Institutin Gjyqësor të Kosovës  
Znj. Lumnije Krasniqi, koordinatore e programit në Institutin Gjyqësor të Kosovës  
Znj. Mary Agvirre-Shahin, këshilltare speciale e OSBE-së për Institutin Gjyqësor të Kosovës

Përkthyer nga:

Linda Fejzullahu, asistente e lartë gjuhësore  
Gëzim Fetahu, asistent i lartë gjuhësor  
Ismet Sadriu, asistent i lartë gjuhësor

Mbështetja teknike nga::

Drita Kurteshi, asistente administrative  
Xhevdet Pllana, zyrtar i lartë i TI-së

Ky publikim është përkrahur financiarisht nga UNWOMEN, qëndrimet dhe mendimet e shprehura në këtë studim nuk reflektojnë ato të UNWOMEN-it



## P Ë R M B A J T J A

Parathënie.....	5
Hy r j e .....	6
Nëse je viktimë e dhunës ndërmerr këta hapa .....	8
Strehimoret e viktimave të dhunës në familje në Kosovë .....	9
Standardet Ndërkombëtare për Dhunën në Familje .....	10
Konventa “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave” (CEDAW)1979 .....	11
Roli i Këshillit të Europës lidhur me dhunën në familje .....	11
Konventa për dhunën në familje .....	11
Standardet ligjore kosovare për dhunën në familje.....	13
Kushtetuta e Republikës së Kosovës.....	13
Ligji për Familjen i Kosovës.....	13
Familja sipas legjislacionit kosovar.....	13
Parimet mbi rregullimin e marrëdhënieve familjare .....	14
Të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve .....	14
Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje .....	14
Çka konsiderohet marrëdhënie familjare .....	14
E dini ç’është dhuna në familje .....	15
Format e dhunës në familje .....	16
Dhunë fizike .....	16
Dhunë psikologjike .....	16
Dhunë seksuale.....	17
Dhunë ekonomike.....	17
Izolimi si formë e dhunës në familje .....	18
Faktorët që mund të shkaktojnë dhunën në familje .....	19
Shkaqet e dhunës në familje .....	19
Gratë si viktimë të dhunës në familje .....	20
Pasojat e dhunës në familje te gratë .....	21
Fëmijët si viktimë të dhunës në familje .....	22
Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës.....	22
Dhunë fizike .....	22
Dhuna mendore.....	22
Pasojat e dhunës familjare tek fëmijët .....	23
Ligji për Policinë e Kosovës.....	24
Çka duhet të ndërmerrni nëse jeni viktimë e dhunës në familje .....	24
Paraqitja e rastit të dhunës në familje .....	24
Kryerësi i dhunës në familje .....	24
Detyrimet e shtetit dhe shoqërisë lidhur me dhunën në familje .....	25
Shteti .....	25
E dini ç’është mbrojtësi i viktimave ? .....	25
Policia.....	26
Çfarë mund të bëjë policia e Kosovës për ju, nëse jeni viktimë e dhunës në familje .....	26

Policia e Kosovës mund të lëshojë urdhër për mbrojtjen e përkohshme emergjente .....	27
Zyrat për Ndihmë Juridike në Kosovë .....	28
Gjykata .....	29
Inicimi i procesit gjyqësor kur ka dhunë në familje.....	29
Kërkesa.....	29
Kush mund ta paraqesë kërkesën për urdhër mbrojtje dhe urdhër për mbrojtje emergjente? .....	30
Gjykata do ta shqyrtojë kërkesën me efikasitet dhe drejt.....	30
Urdhri për mbrojtje emergjente që e shqipton gjykata.....	31
Urdhri për mbrojtje.....	32
Gjykata bashkë me urdhrat mund të shqiptojë një apo më shumë nga masat.....	33
Veprimet e prokurorit publik kur nga dhuna në familje është kryer vepër penale.....	34
Mekanizmat shtetërorë dhe joqeveritarë në Republikën e Kosovës që përkujdesen për mirëqenien e grave dhe fëmijëve.....	35
Informatat për kontaktim të ombudspersonit (Avokati i popullit).....	36
Konkluzione .....	37
B u r i m e t .....	38



## **P a r a t h ë n i e**

Dhuna në familje është problem serioz në të gjithë botën dhe ka ndikim negativ në familje dhe shoqëri. Në disa regjione të Kosovës dhuna në familje po shënon rritje, dhe kjo për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike, përdorimit të tepërt të alkoolit, stresit dhe faktorëve të tjerë përcjellës. Dhuna në familje ekziston në disa forma, duke filluar prej abuzimit emocional e deri edhe me vdekje.

Qëllimi i këtij manuali është që t'iu ofrojë viktimave të dhunës në familje informata se si të kërkojnë ndihmë kur ato përjetojnë dhunë në familje. Ky manual paraqet rolin e qeverisë, policisë, gjyqtarëve, prokurorëve, shoqërisë civile dhe akterëve të tjerë të cilët punojnë në asistimin e viktimave të dhunës në familje. Udhërrëfyesi gjithashtu ofron informata esenciale rreth ligjeve me të cilat rregullohen rastet e dhunës në familje si dhe procedurat ligjore për mbrojtjen e viktimave të kësaj dukurie, përfshirë këtu lëshimin e urdhrat mbrojtës, urdhrin mbrojtës emergjent dhe urdhrat tjerë që lëshohen nga ana e gjyqtarit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.

Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK), në bashkëpunim dhe me mbështetje të plotë të projektit UNWOMEN në Kosovë, ka bërë të mundur publikimin e këtij manuali. IGJK-ja si institucion i vetëm përgjegjës për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve është i përkushtuar në trajnimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve në çështjen e të drejtave të grave. Në vitin 2011 IGJK certifikoi 19 gjyqtarë dhe prokurorë në lëmin e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore. Këta trajnues mbajnë trajnime për të drejtat e grave në pesë regjione të Kosovës. Trajnime për dhunën në familje u mbajtën edhe për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë të Programit Fillestar për Arsimim Ligjor.

IGJK beson në drejtësinë e arritur përmes arsimimit ligjor dhe është i përkushtuar të ofrojë trajnime të kualitetit të lartë në çështjet më të rëndësishme, të cilat ndikojnë në jetën e qytetarëve duke siguruar kështu funksionimin e plotë dhe të drejtë të gjykatave të Kosovës. Viktimat e dhunës në familje gjithmonë dhe në çdo kohë kanë të drejtohen për ndihmë, prandaj gjyqësori i Kosovës luan rol të rëndësishëm në mbrojtjen e këtyre viktimave.

Ne besojmë se ky udhërrëfyerës është edhe një kontribut më tepër në rritjen e reagimit të kërkuar nga ligji ndaj dhunës në familje.

Mr. Sc. Lavdim Krasniqi,  
Drejtor në Institutin Gjyqësor të Kosovës

## Hyrje

Dhuna ndaj grave është shkëlja e të drejtave të njeriut, më e përhapur në botë, e cila i prek ato të të gjitha moshave, kulturave, pa marrë parasysh nivelin e arsimimit dhe prejardhjen socio-ekonomike, që nuk njih kufij dhe është prezentë në të gjitha vendet e botës. Dhuna mund të ndodhë në shtëpi, në rrugë, në shkollë, në vend të punës, gjatë konflikteve, dhe mund të jetë fizike, emocionale, seksuale, psikike dhe ekonomike.

Dhuna ndaj grave ka pasoja të mëdha si për familjen ashtu dhe për tërë komunitetin. Sipas statistikave globale shkaku kryesor i vdekjes së grave dhe vajzave, të moshës 16-44 vjeçare, është dhuna që ushtrohet më së shpeshti nga personat e afërt, siç janë bashkëshorti ose partneri. Kur një person në marrëdhënie martesore, paramartesore, që bashkëjeton, i divorcuar, ose në çfarëdo marrëdhënie të ngushtë, keqtrajton dhe abuzon tjetrin, atëherë kemi të bëjmë me dhunën në familje. Në bazë të disa studimeve të kryera, për dhunën në familje, është vërtetuar se dhuna ndaj grave është një problem kompleks dhe shumë dimensional. Pa marrë parasysh kornizën ligjore dhe institucionale për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe pavarësisht përpjekjeve dhe masave që ndërmerren për ta parandaluar dhe minimizuar atë nga organet shtetërore dhe nga organizatat joqeveritare, dhuna në familje vazhdon të jetë një ndër fenomenet më problematike në shoqërinë tonë.

Në Kosovë, që nga viti 2004, raportohen përafërsisht 1000 raste të dhunës në familje brenda një viti, ku më shumë se 85 % të viktimave janë gra. Ndërsa, në vitin 2010 janë gjithsej 944 raste të raportuara, 754 kanë qenë viktimë gratë dhe 190 kanë qenë viktimë meshkujt. Sipas policisë, ndër rastet e raportuara për dhunë ndaj meshkujve nga babai, axha, vëllai apo lidhje të tjera, përfshihen edhe 11 rastet e denoncuar si dhunë fizike ndaj burrit e dyshuara është gruaja. Megjithatë, rastet e dhunës në familje janë rritur në tremujorin e dytë të vitit 2011, në krahasim me tremujorin e parë të të njëjtit vit. Sipas statistikave të policisë, nga janari deri në mars të vitit 2011, është kërkuar ndihma e policisë në 178 raste. Për sa i përket periudhës nga prilli deri në korrik të të njëjtit vit, ndihma e policisë është kërkuar në 234 raste. Sipas statistikave, numri më i lartë i rasteve të tilla është raportuar në komunën e Pejës.

Një tjetër sfidë, lidhur me dhunën në familje, është se në shumë raste viktimat nuk raportojnë rastin e dhunës. Sipas raporteve botërore dhe vendore diku rreth 50 % të rasteve të dhunës në familje nuk denoncohen.

Në Kosovë legjislacioni në lidhje me barazinë gjinore, të drejtat e grave dhe mbrojtjen nga dhuna, është mjaft i avancuar. Në veçanti, nga viti i kaluar Kosova ka Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje si dhe strategjinë dhe planin e veprimit. Mirëpo sfida kryesore është zbatimi i këtyre ligjeve dhe strategjive në praktikë, në jetën e përditshme. Me qëllim që të kontribuohet në zbatimin e LMDHF dhe të ngritet niveli i mbrojtjes së grave (dhe fëmijëve) nga dhuna në familje është përgatitur ky udhërrëfyes nga Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK).

Udhërrëfyesi do t'u shërbejë së pari gjyqtarëve dhe prokurorëve, që ata në punën e tyre të përditshme të aplikojnë ligjet e avancuara për të drejtat e grave, në veçanti Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Mirëpo do të jetë një udhërrëfyes edhe për policinë, organizatat joqeveritare dhe sidomos për vetë viktimat e dhunës.

Udhërrëfyesi është rezultat i punës dhe trajnimit të vazhdueshëm të IGJK-së me gjyqtarët/et me përkrahjen e UN Women, për legjislacionin ndërkombëtar dhe vendor në fushën e të drejtave njerëzore të grave dhe barazisë gjinore.

Ky udhërrëfyes ka për qëllim që të japë një pasqyrim të shkurtër dhe të qartë për legjislacionin ndërkombëtar dhe vendor si dhe për mekanizmat mbrojtës nga dhuna në familje. Po ashtu ofron instruksione të qarta për sistemin gjyqësor dhe aplikimin e Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe njëherit ofron informata të mjaftueshme për viktimat e dhunës në familje dhe hapat që mund të ndërmerren për viktimat kur ndaj saj është ushtruar njëra ndër format e dhunës. Paraprakisht, do të përcaktojë rëndësinë dhe rrugën më të drejtë të mundshme, duke dhënë informacione të sakta dhe kuptimplote si dhe duke nxjerrë në shesh problematikat e përgjithshme.

Qëllimi është që nëpërmjet këtyre analizave, të mundësojmë një kuptim të përgjithshëm të objektit për të dhënë njohuri për çështjet bazë siç janë:

- Informimi për standartet ndërkombëtare dhe vendore, që kanë të bëjnë për dhunën në familje;
- Çka shkakton dhuna familjare;
- Identifikimi i formave të dhunës në familje;
- Listimi i organeve shtetërore (policia, gjykatat dhe mekanizmat tjerë shtetërorë, të cilat janë të obliguara t'u ndihmojnë viktimave të dhunës në familje);
- Veprimet të cilat i ndërmerr gjykata, prokuroria dhe policia, kur pranë saj paraqitet çështja e dhunës në familje.



Nëse je viktimë  
e dhunës  
në familje  
ndërmerr  
këta hapa:

- Shko diku ku do të ndihesh më sigurt;
- Paraqit rastin në polici;
- Me ndihmën e organit policor të mirren provat;
- Të bëhet fotografimi dhe paraqitja te mjeku, i cili do të ju ofrojë ndihmën adekuate;
- Kërko nga organi policor që dikush të marrë fëmijët në kujdes.

- Me ndihmën e organit kompetent për ju caktohet mbrojtësi i viktimave për të ofruar ndihmën profesionale.

- Paraqit kërkesë në gjykatë;
- Ju duhet të merrni pjesë në shqyrtimin e kërkesës suaj.


- Ju mund të vendoseni në strehimore bashkë me fëmijët tuaj;
- Këto ju ofrojnë siguri dhe mbështetje gjatë qasjes suaj në drejtësi dhe ndihma të tjera adekuate.
- Në të gjitha regionet e Kosovës ekzistojnë strehimoret.

## **Strehimoret e viktimave të dhunës në familje në Kosovë**

Strehimoret u ofrojnë strehim viktimave të dhunës në familje si: sigurimin e ushqimit dhe të veshmbathjes, mbështetje psiko-sociale dhe në bashkëpunim me institucionet përkatëse i ofrojnë atyre përkujdesje mjekësore, juridike, trajnime edukative për ngritjen e vetëdijesimit dhe fuqizimit të tyre si dhe aktivitete tjera rekreative.

Roli kryesor i strehimoreve është ofrimi i sigurisë së viktimave të dhunës në familje dhe fëmijëve të tyre, sipas nevojës para, gjatë dhe pas procedurës gjyqësore. Përmes këshillimit individual dhe grupor, ato gjithashtu ofrojnë mbështetje psikologjike për gratë pasi që përjetojnë vështirësi dhe periudha traumatizuese në jetën e tyre.

### **Kosova ka këto strehimore të viktimave të dhunës në familje**



“Dhuna ndaj grave është shkelja më e turpshme e të drejtave të njeriut. Derisa dhuna vazhdon ne nuk mund të pohojmë që jemi duke bërë një progres të vërtetë në drejtim të barazisë gjinore, zhvillimit dhe paqes”.


(\* Mars 1999, Kofi Anan, Sekretar i përgjithshëm i KB)

## Standardet ndërkombëtare për mbrojtjen nga dhuna në familje

Sot standardet ligjore ndërkombëtare ndalojnë dhunën në familje, si shkelje e të drejtave njerëzore dhe lirive themelore, të garantuara për të gjithë individët pa asnjë dallim.

## Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

- E drejta për barazi;
- Liria nga diskriminimi;
- E drejta e jetës, lirisë dhe sigurisë personale;
- Liria nga tortura dhe trajtimet mizore, çnjerëzore ose poshtëruese;
- E drejta e njohjes si një person para ligjit;
- E drejta për barazi përpara ligjit;
- E drejta për mjete juridike nga gjykata kompetente;
- E drejta për barazi në familje;
- E drejta për standardin më të lartë të arritshëm, për shëndetin fizik dhe mendor;
- Çdo njeri gëzon të drejtën e rendit shoqëror dhe ndërkombëtar, në të cilin të drejtat dhe liritë e parashikuara në këtë deklaratë mund të realizohen plotësisht.



## Konventa “Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave” (CEDAW) - 1979

CEDAW përcakton standardet legale për arritjen e barazisë gjinore përmes eliminimit të diskriminimit ndaj gruas. Qëllimi i konventës është krijimi i barazisë gjinore për gratë në të gjitha fushat e jetës, qofshin ato politike, sociale, ekonomike dhe kulturore. Konventa e bën të qartë që gratë kanë të drejtën e një gëzimi të plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave të tyre njerëzore.

Konventa synon të sigurojë barazinë, si detyrim parësor për shtetet palë dhe përmirësimin e pozitës së grave në shoqëri. Konventa lufton ideologjinë gjinore duke kërkuar një ndryshim të qëndrimit tradicional ndaj gruas. (<http://www.un.org/womenwatch/daw/cdaw>)

### Roli i Këshillit të Evropës lidhur me dhunën në familje

Këshilli i Evropës, si organizatë ndërqeveritare rajonale, ka drejtuar vëmendjen nga mbrojtja e të drejtave të njeriut, që nga themelimi, në vitin 1948. Sistemi i të drejtave të njeriut e Këshillit të Evropës është bazuar në traktatet, të cilat përcaktojnë detyrimet për shtetet anëtare, si dhe në direktiva, rekomandime dhe rezoluta.

**Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Neni 3 i Konventës Evropiane);**

Askush nuk do t'i nënshtrohet torturës, as dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore.



**Këshilli i Evropës, me Seli në Strasburg të Francës**

**Konventa për Dhunën në Familje** – e miratuar në Maj 2011, dhe e ratifikuar nga 15 shtete.

- Thërret për themelimin e linjave për ndihmë SOS, strehimoreve, shërbimeve mjekësore dhe forenzike, këshillimoreve dhe shërbimeve për ndihmë ligjore.
- Është e dizajnuar që t'u ofrojë ndihmë 25 % të grave në Evropë, të cilat kanë përjetuar dhunë fizike ose seksuale gjatë jetës së tyre.
- Hap rrugën për krijimin e kornizës ligjore në nivel evropian për mbrojtjen e grave nga të gjitha format e dhunës dhe parandalimin dhe eliminimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. <https://wcd.coe.int/wcd/>

- Karta Sociale Evropiane;
- Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës, të Trajtimeve ose Ndëshkimeve Çnjerëzore dhe Poshtëruese;
- Rezoluta “**Për Dhunën Kundër Grave**” e vitit 1986. Ajo bëri thirrje për njohjen ligjore të përdhunimit martesor, për organizimin e trajnimeve për ata që mund të jenë në kontakt me viktimat e dhunës në familje, dhe rekomandoi që grave t’u sigurohet asistencë ligjore.
- Parlamenti Evropian miratoi rezolutën për nevojën për të ndërmarrë një fushatë të gjerë të BE-së për tolerancë “zero” ndaj dhunës kundër grave më 1997.
- Presidenca e BE-së, çështjen e dhunës në familje e ka vendosur në axhendën politike që prej vitit 1998 dhe ka miratuar një numër rekomandimesh që trajtojnë kryesisht dhunën në familje.
- Konferencë e Këshillit të Evropës për të luftuar dhunën ndaj grave, përfshirë dhunën në familje Strasburg, 10 dhe 11 Qershor 2008.
- Parlamenti Evropian miratoi rezolutën për të ndërmarrë një fushatë të gjerë të BE-së për tolerancë “**ZERO**” ndaj dhunës kundër grave më 1997;
- Presidenca e BE-së, çështjen e dhunës në familje e ka vendosur në axhendën politike që prej vitit 1998 dhe ka miratuar një numër rekomandimesh që trajtojnë kryesisht dhunën në familje;
- Rekomandimi Rec (2002)5 i Komitetit të Ministrave, të shteteve anëtare mbi mbrojtjen e grave nga dhuna, miratuar më 30 Prill 2002, shoqëruar me Memorandumin Shpjegues. Ky rekomandim përmban detyrimin që të njohin dhunën



**Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg**

e burrave ndaj grave si një problem madhor strukturor dhe shoqëror, i cili vjen si rezultat i marrëdhënieve të pabarabarta të pushtetit mes burrave dhe grave, dhe të nxisin për këtë arsye pjesëmarrjen aktive të burrave në veprime që kanë si synim luftën e dhunës ndaj grave.

- Konferenca e Këshillit të Evropës për të luftuar dhunën ndaj grave, përfshirë dhunën në familje Strasburg, 10 dhe 11 Qershor 2008.

## Standardet ligjore të Kosovës për dhunën në familje

Në Kosovë janë në fuqi një numër aktesh juridike që garantojnë liritë, të drejtat dhe detyrimet e të gjithë qytetarëve pa dallim gjinie, feje, etnie siç janë:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Ligji për Familjen i Kosovës;
- Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;
- Ligji për Barazinë Gjinore;
- Ligji për Policinë e Kosovës;
- Kodi Penal i Kosovës.

Të barabartë në të drejta dhe përgjegjësi, ju garanton Kushtetuta.

## Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta përcakton parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, dhe kjo i ka hapur rrugë zhvillimit të së drejtës së brendshme, ashtu që i tërë sistemi ligjor kosovar është i bazuar në parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit.

### Kushtetuta garanton:

- Zbatimin e drejtpërdrejtë të Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare **(Neni 22)**;
- Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut **(Neni 23)**;
- Të drejtën që të marrë vendime lidhur me reproduktimin, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me ligj;
- Të drejtën për kontroll mbi trupin e saj/tij në pajtim me ligjin;
- Të drejtën që të mos i nënshtrohet trajtimit mjekësor kundër vullnetit të tij/saj në pajtim me ligjin;
- Të drejtën për të mos bërë eksperimente mjekësore ose shkencore, pa pëlqimin paraprak të saj/tij pëlqimin paraprak të saj/tij **(Neni 26)**.



## Ligji për Familjen i Kosovës (Ligji nr. 2004/32)

### Familja sipas legjislacionit kosovar

Jeta brenda familjes nënkupton marrëdhënie të ndërsjella ndërmjet anëtarëve të saj. Familja është bashkësi vitale e prindërve dhe fëmijëve të tyre si dhe personave të tjerë në gjini. Familja është bërthamë natyrore dhe themelore e shoqërisë dhe si e tillë gëzon të drejtën në mbrojtje.



### Parimet mbi rregullimin e marrëdhënieve familjare

Aty ku ka respekt ka harmoni. Respektojeni njëri-tjetrin!

- Barazia ndërmjet burrit dhe gruas, respekti dhe ndihma e ndërsjellë ndërmjet tyre dhe anëtarëve të familjes;
- Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe përgjegjësia e të dy prindërve për rritjen dhe edukimin e tyre, ku fëmijë nënkupton personin nën moshën 18 vjeçare;
- Prindërit dhe fëmijët detyrohen në ndihmë dhe konsideratë të ndërsjellë gjatë tërë jetës së tyre **(Neni 3)**.

### Të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve

Ju jeni të barabartë, mbështeteni njëri-tjetrin!

- Bashkëshortët në martesë janë të barabartë, në të gjitha marrëdhëniet personale dhe pronësore;
- Martesa lidhet për tërë kohëzgjatjen e jetës;
- Bashkëshortët janë të detyruar të jenë besnikë ndaj njëri-tjetrit dhe në mënyrë reciproke ta ndihmojnë, respektojnë dhe mbështesin financiarisht njëri-tjetrin, posaçërisht në rastet kur njëri prej tyre nuk ka bazë të mjaftueshme materiale për jetesë;
- Bashkëshortët do të zhvillojnë dhe shprehin ndjenjën e solidaritetit reciprok, si dhe solidaritetin ndaj fëmijëve të tyre të lindur në martesë apo të adoptuar **(Neni 42)**.

### Ligji për mbrojtje nga Dhuna në Familje (Ligji Nr. 03/L-182)

E dini që ju jeni në marrëdhënie familjare, respektojeni dinjitetin e secilit!

#### Marrëdhënie familjare konsiderohen nëse personat:

- janë të fejuar apo ishin të fejuar;
- janë të martuar apo ishin të martuar;
- janë në bashkësi jashtëmartesore apo ishin në bashkësi jashtëmartesore;
- bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët ose që bashkëjetuan në një ekonomi të tillë;
- përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martese, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat, vëllezërit dhe motrat, hallat e tezet, xhaxhallarët e dajallarët ose kushërinjtë;
- janë prindër të një fëmije të përbashkët;
- janë palë procedurale në një kontest nga marrëdhëniet familjare **(Neni 1.1)**.



**E dini ç'është dhuna në familje?**

**Thuaj ndal dhunës në familje, gjeji zgjidhje tjera!**

Dhuna në familje përfshin kombinim të pushtetit dhe të kontrollit që shfrytëzohen për të shkaktuar dhimbje dhe frikë tek viktima, me qëllim që të vëhet kontroll mbi të, të poshtërohet dhe të dobësohet.

Dhuna në familje është mënyrë e sjelljes sipas së cilës një bashkëshort ose anëtar i familjes më të gjerë përdor dhunë fizike, detyrim, frikësim, izolim ose keqpërdorim emocional, seksual ose ekonomik për ta kontrolluar partnerin/anëtarin tjetër të familjes në lidhjen/amvisërinë. Njëkohësisht, dhuna ndaj personave të tjerë që jetojnë në martesë ose në bashkësi jashtëmartesore ose amvisërisë, si dhe ndaj partnerit jashtëmartesor ose persona që kanë fëmijë se janë shumë të afërt me marrëdhënie të afërta personale.

**Dhunë në familje** - është një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme, që i bën një person personit tjetër, me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, por nuk kufizohet në:



**Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (Ligji Nr. 03/L-182)**

**Dhuna nuk justifikohet kurrë, mos e përdor atë!**

- përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes;
- çdo veprim tjetër i një anëtari të familjes që mund të shkaktojë apo kanos, se do të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike;
- shaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit;
- sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat;
- ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë;
- përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përruljes së personit tjetër;
- marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual;
- kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër;
- dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë;
- vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike;
- Hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesën e personit tjetër;
- rrëmbimi (**Neni 2 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LMDHF**).



## Format e dhunës në familje

Në shoqërinë e sotme kosovare vihet re një rritje e fenomenit të dhunës në familje, e cila ushtrohet më shumë mbi gratë dhe vajzat, fëmijët dhe të moshuarit. Studimet tregojnë se dhuna shfaqet në të gjitha format si:

**Dhunë fizike** - konsiderohet: rrahja, përdredhja e krahëve, djegia, shqelmimet, kërcënimet me armë, shtyrja, goditja, gërvishtja, pickimi, kafshimi, **hedhja**, mbyllja në shtëpi, goditja me objekte të ndryshme, refuzimi për ta ndihmuar gruan kur ajo është shtatzënë ose e sëmurë, deri në formën më të rëndë, plagosja, vrasja e mbetur në tentativë dhe vrasja.

**Dhunë psikologjike** - nënkuptohen sjelljet që synojnë poshtërimin dhe persekutimin, duke përfshirë: kërcënimin, mbylljen në shtëpi, fytyrjen, vëzhgimin, kërcënimin se do t'i merret kujdestaria e fëmijëve, shkatërimin e objekteve (p.sh. të fotografive, portreteve) izolimin, përqeshjen, agresionin verbal dhe poshtërimin.



Presioni psikologjik  
është dhunë.

Njëkohësisht, injorimin e ndjenjave të bashkëshortes, kritika të vazhdueshme, kundërshtim i vazhdueshëm i mendimeve, poshtërim në publik me fjalë fyese, përpjekje për ta bindur partneren se dhunën e meriton nga veprimet e veta, akuzimi i partneres për tradhti bashkëshortore, shenja xhelozie të vazhdueshme, fshehjen e parave, mbajtje në shtëpi duke ndaluar punësimin, abuzimin me fëmijët, thirrje me emra poshtërues etj.

**(Neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, pika 1.2.1 të LMDHF).**

**Dhunë seksuale** - konsiderohet akti seksual i detyruar me kërcënime, me forcë fizike dhe poshtërim, detyrim për akte seksuale të padëshiruara apo detyrim për të bërë seks me të tjerë, trajtimin e partneres (partnerit) si objekt seksual. Po ashtu detyrimin për të bërë striptizëm, kryerjen e akteve seksuale sadiste, detyrimin e partneres të bëjë seks pas abuzimit fizik ose si kusht për të ruajtur marrëdhënien e tyre, shtytje që të kryejë marrëdhënie seksuale jashtëmartesore etj.

(Neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, pika 1.2.7 të LMDHF)



Mosrespektimi i vullnetit dhe cenimi i dinjitetit është dhunë. Dhuna dënohet.

**Dhunë ekonomike** - përfshin mohimin e fondeve, refuzimi për të kontribuar financiarisht, mohimi i ushqimit dhe i nevojave themelore, kontrolli i përfitimit të kujdesit shëndetësor. Kjo formë e dhunës ka të bëjë me kontrollin e partnerit mbi të ardhurat financiare të familjes apo edhe ndalimin e pjesëmarrjes së gruas në vendimet për shpenzimet e parave, madje edhe refuzimi i dhënies së parave për të mbuluar nevojat bazë të familjes, mohimi i pronësisë mbi pasurinë e përbashkët, dëmtim ose shkatërrim të pasurisë, vjedhje të pasurisë, etj.

(Neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, pika 1.2.9 të LMDHF)

*"Burri m'i merr të gjitha paratë. Ai nuk pyet për fëmijët dhe për nevojat që kemi. Ai mendon vetëm për vete. Del për çdo natë, dhe kthehet vonë, më fyen dhe më përbuzë...Ai gjithmonë me rrihte shumë, por më kujtohet një rast kur më rrahu si asnjëherë më parë. Atë ditë ai erdhi në shtëpi vonë, ishte ora 3 e natës isha në gjumë me fëmijë, burri ishte krejtësisht i dehur. Filloi të më rrahë dhe unë nuk e kuptoja se pse. Ai më goditi me një shishe në kokë. Mua më rridhte gjak....."*

Deklaron një grua viktimë e dhunës në familje.



## Izolimi si formë e dhunës në familje

Izolimi është formë e dhunës në familje, e cila kryhet duke ia kufizuar lirinë e lëvizjes në mënyrë të paligjshme personit tjetër dhe ndalimi i personit tjetër nga hyrja ose dalja prej një vendbanimi të përbashkët. Izolimi është mohimi dhe cenimi i kushteve elementare për jetesë që ushtrohet ndaj një anëtari të familjes.

Izolim kemi atëherë kur një personi i është ndaluar lëshimi i dhomës, shtëpisë, mbajtja nën kontroll pa kurrfarë të drejte, ndërveprimi me anëtarët e tjerë të familjes me shokët, kolegët, mohimi i qasjes në dokumente personale të identifikimit.

Kryerësi i kësaj dhune bën kontrollimin e lëvizjes së një anëtari tjetër të familjes, duke përdorur dhunë. Kjo ndodh kur burri e mban të ngjuar gruan në dhomë, duke ia mohuar lëvizjen e lirë, mohimi për të përdorur tualetin, ndalimi për të komunikuar lirshëm dhe për të bashkëvepruar me persona të tjerë.

Njëkohësisht, kufizimi se ku mund të shkojë gruaja nga ana e burrit, konfiskimi apo shkatërrimi i dokumenteve personale identifikuese, ndalimi që t'i takojë-vizitojë miqtë apo familjen, ndalimi për pjesëmarrje në aktivitete jashtë shtëpisë, pengimi-vështirësimi përmes metodave të ndryshme të takimeve me familjarët apo miqtë.

Po ashtu, mbyllja e vjehrrës apo vjehrrit në dhomë nga ana e resë, mbyllja e fëmijës në dhomë nga prindërit apo thjeshtërit, mbyllja në shtëpi e personit me aftësi të kufizuara, etj. **(Neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, pika 1.2.8 të LMDHF).**

**Pengimi i lirisë së lëvizjes është krim. Mohimi i kësaj të drejte paraqet shkelje të dinjitetit dhe personalitetit të njeriut.**



## Faktorët që mund të shkaktojnë dhunën në familje

Dhuna në familje mund të shkaktohet nga çrregullimet e personalitetit, nga alkooli apo droga, humbja e vetëkontrollit, zemërimi, stresi apo problemet në marrëdhënie në çift. Dëshira për të sunduar dikë dhe për të vendosur e për të ushtruar pushtet e kontroll ndaj tjetrit është faktori kryesor i dhunës në familje. Kjo mund të shfaqet në formë të pushtetit dhe kontrollit që vendosin bashkëshortët ndaj njëri-tjetrit, prindi ndaj fëmijës, personat të tjerë ndaj personave me paaftësi dhe të moshuarëve, mund të jenë faktorë të tjerë që shkaktojnë dhunën në familje.

**Faktorë të tjerë (sekondarë) që mund shkaktojnë dhunën në familje janë:**

- **Faktorë të jashtëm shoqërorë:** ndikimi i kulturës, ekonomisë, politikës, lëvizjet e mëdha demografike.
- **Faktorë të brendshëm familjarë:** modelet me të cilat janë rritur, edukata e familjes, mënyra e rritjes së fëmijëve.
- **Faktorë të nivelit personalë:** problemet e shëndetit mendor të individit, abuzimin me alkoolin, drogën, streset, nivelin kulturor, çrregullimet e ndryshme të personalitetit, përvojat personale në marrëdhëniet familjare, kushtet e vështira ekonomike, mungesa e njërit prind.

## Shkaqet e dhunës në familje

- Konsumimi i alkoolit;
- Përdorimi i drogës;
- Xhelozia;
- Dëshira për të pasur ndikim tek bashkëshorti
- Bixhozi;
- Karakteri i dhunshëm-agresiv;
- Papunësia;
- Gjendja e vështirë ekonomike;
- Çështje pasurore - pronësia e përbashkët e bashkëshortëve;
- Mosmarrëveshjet - konfliktet familjare;
- Zgjidhja e martesës (kur bashkëshortët gjenden në procedurën e shkurorëzimit);
- Lidhja jashtëmartesore – tradhtia
- bashkëshortore;
- Konflikte për kujdestarinë e fëmijëve;
- Mentaliteti;
- Bashkëshortët rrjedhin nga familje në të cilat ka qenë prezente dhuna familjare në moshën e fëmijërisë;
- Shtytja e anëtarëve të familjes duke mveshur gjëra të pavërteta;
- Ndalimi për të krijuar marrëdhënie pune, për të shkuar në shkollë etj.

**Konsumimi i tepërt i alkoolit-shkatërron familjen.**



## Gratë si viktima të dhunës në familje

Personi i cili i nënshtrohet dhunës në familje është viktimë. Dhuna fizike e vazhdueshme, e shoqëruar me dhunë emocionale, seksuale dhe ekonomike shkakton efekte të shumëfishta tek gratë. Në shumicën e rasteve të dhunës në familje gratë janë viktima. Nganjëherë dhuna bëhet aq e padurueshme sa që gratë fillojnë të mendojnë edhe vetëvrasjen.

Prandaj, nuk është aspak çudi që gratë e dhunuara fizikisht, psikologjikisht apo seksualisht janë të lënduara emocionalisht. Shenjat më të zakonshme të dhunës në familje, që përmendin gratë, janë ankthi, depresioni, lodhja, nervozizmi, dhimbjet e kokës, mungesa e koncentrimit dhe pagjumësia.

**(Neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 të LMDHF)**



Gratë, të cilat kanë qenë viktima të dhunës familjare, duhet të inkurajohen dhe të mbështeten për të krijuar e zhvilluar marrëdhënie me botën që i rrethon. Ato duhet të inkurajohen të jenë pjesë e jetës ekonomike dhe shoqërore.

**Për informata shtesë kontakto:**

*Agjencia për Barazi Gjinore (ABG),  
pranë zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës,  
038 -14 -281*

Duke denoncuar rastin ju i shpallni luftë dhunës në familje.

**Nëse je viktimë e dhunës në familje kontaktoni policinë!  
Telefoni numrin gratis:  
112 apo 92.**



Në kuadër të Policisë së Kosovës ekziston Sektori i Hetimeve Kundër Dhunës Familjare, që vepron në kuadër të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve të Rënda, Drejtorisë e Përgjithshme. Sektori është i strukturuar në tre nivele në vijë vertikale:

- Nivel qendror (1 toger dhe 2 rreshterë);
- Nivel regjional (dy hetues); dhe
- Nivel të stacioneve (dy hetues primarë), që mund të kontaktohen **24 orë** për të gjitha rastet e dhunës në familje, të cilët do t'i përgjigjen thirrjes duke shkuar në vendin e ngjarjes për të hetuar rastin, dhe nëse ka bazë rasti procedohet në prokurorinë kompetente.

## Pasojat e dhunës në familje tek gratë

- **Pasojat psikike** - stresi shumë të madh psikologjik, depresioni, frika, ankthi, mungesa e vetëvlerësimit, anoreksi dhe pagjumësia, gjendja e pasigurisë në vetvete, çrregullimi pastraumatik, tentativa për vetëvrasje.
- **Pasojat fizike** - rezultojnë me dëmtime fizike si thyerje e ekstremiteteve (dhëmbëve, hundës, nofullës, duarve, këmbëve, gishtërinjve) dhe thyerje e pjesëve të tjera të trupit, nga të cilat veprime mund të shkaktohet edhe paaftësi fizike e pjesshme ose e përhershme, plagosje të lehta apo të rënda trupore etj.
- **Pasoja që lidhen me shëndetin riprodhues** - shtatzëni të padëshiruara, probleme gjinekologjike si: sëmundje seksualisht të transmetueshme, aborte, lindje të parakohshme ose nën peshë të foshnjes etj.
- **Pasojat e humbjes së harmonisë familjare** – që shpesh në praktikë përfundojnë me shkurorëzim, marrje me prostitucion, rënia si viktimë e trafikimit etj.



## Fëmijët si viktimë të dhunës në familje Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës

**Dhunë fizike** – përbën shtyrje, përplasje për dysheme, përplasje koke për krevati, te tavolina kur fëmija është duke konsumuar ushqim, përplasje koke në mure dhe në bankë, shkulje veshi, flokësh, shkulje qimesh, shkulje gishtash. Po ashtu dhunë fizike cilësohet edhe lidhja me litar për ta mbajtur të kufizuar fëmijën, mosushqimi i rregullt, detyrimi për të punuar dhe për të kërkuar lëmshë, incesti, kufizimi i lëvizjes, ndalimi për të lozur...etj.

Përqafoje! Është  
fëmijë, është fëmija i  
juaj. Ndal dhunës!

**Dhuna mendore** - përfshin atë sjellje kur të rriturit, anëtarë të familjes, e keqtrajtojnë psikikisht fëmijën përmes: refuzimit, reduktimit të lojërave, injorimit, pakënaqësisë, izolimit ose mbylljes së fëmijës, duke e injoruar, ofenduar ose poshtëruar në mënyra a forma të vazhdueshme, duke e frikësuar dhe kërcënuar se do të lihet vetëm në shtëpi apo në bodrum të errët, etj. Këtë dhunë mund ta kryejnë prindërit, vëllai i madh apo motra, apo ndonjë anëtar tjetër i familjes.

Andaj, shteti duhet të ndërmerrë të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, si fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij, ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë apo të çdo personi tjetër të cilit i është besuar (**Neni 19 Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës**).



## Pasojat e dhunës familjare tek fëmijët

Fëmijët ndikohen nga dhuna në familje po aq sa edhe prindi i tyre, ndonjëherë edhe më shumë, edhe në rastet kur ata nuk janë viktimë e drejtpërdrejtë e dhunës. Niveli i zhvillimit të tyre psikologjik nuk i lejon të kuptojnë situatën e dhimbshme në familje, të cilën e përjetojnë. Një situatë e tillë familjare, që i shoqëron ata gjatë zhvillimit psikofizik të tyre, lë gjurmë të pashlyeshme dhe ndikon në formimin e personalitetit të tyre.

Ata marrin role të rëndësishme në familje, si kujdesi për motrat dhe vëllezërit më të vegjël, dhe përpiqen të bëjnë gjëra që t'i bëjnë të lumtur prindërit e tyre, në mënyrë që ata të ndjehen mirë.

Ata janë të prirur të ndërpresin kontaktet me shokët e tyre sepse kanë frikë se mos incidentet e dhunshme ndodhin në prezencën e tyre. Ata izoloohen në një moshë të hershme dhe janë të rrezikuar të marginalizohen në shoqëri.



Këta fëmijë shumë shpejt fillojnë të shfaqin vështirësi në procesin e të mësuarit, ju mungon vëmendja, nuk studiojnë mjaftueshëm, humbasin dëshirën për shkollim, bëhen pasivë në klasë, izoloohen, largohen nga orët e mësimit, kanë fjalor të kufizuar dhe vulgar, dhe shpesh arrijnë tek momenti i braktisjes së shkollës.

Fëmijët që rriten në ambiente të dhunshme janë të prirë t'i kthehen dhunës si metodë për zgjidhjen e problemeve kur të arrijnë moshën madhore. Ata janë të rrezikuar që të bëhen përdorues të alkoolit, drogës si dhe të bien ndesh me ligjin.



## Ligji për Policinë e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-035)

### Çka duhet të ndërmerrni nëse jeni viktimë e dhunës në familje?

#### Paraqitja e rastit të dhunës në familje

Dilemat dhe vështirësitë e viktimave për t'u shprehur për dhunën në familje vihen re qartë në praktikë, për shkak të pasojave që mund të rrjedhin më vonë. Viktimat e dhunës në familje frikësohen dhe hezitojnë të raportojnë dhunën, heshtja është gabim.

Dhuna është krim, ajo vret nëse ti hesht.

Viktimat mund të ndërmarrin masa për ta përmirësuar gjendjen e tyre. Andaj, ndërgjegjësimi i tyre për të kuptuar se heshtja është e gabuar, dhe se mbi të gjitha se ato kanë mundësi të ndërmarrin hapa për ta përmirësuar situatën në të cilën ndodhen, është mekanizëm i strategjisë për zhdukjen e dhunës në familje. Nuk ka tolerancë ndaj dhunës, dhuna në familje nuk është çështje private.

#### Policia e Kosovës ka obligim që:

- ta mbrojë jetën, sigurinë dhe pronën e të gjithë personave;
- t'i mbrojë të drejtat dhe liritë themelore të të gjithë personave (Neni 10).

#### Kryerësi i dhunës në familje

Kryerës është personi, i cili ka kryer një apo më tepër vepra të dhunës në familje, kundër të cilit kërkohet t'i shqiptohet urdhri për mbrojtje, urdhri për mbrojtje emergjente. Kryerës të dhunës në familje mund të jenë të profesioneve të ndryshme, me gjendje të ndryshme ekonomike, me shkallë arsimimi të ndryshëm, me përkatësi etnike të ndryshme. Të dhënat tregojnë se gruaja vazhdon të jetë pjesëtari më i dhunuar në marrëdhëniet familjare duke demonstruar në të njëjtën kohë se dhuna ndaj grave është shprehje e pushtetit të burrave mbi to dhe anëtarët e tjerë të familjes.

**Kontaktoni Policinë!**  
**Njësiti për Dhunën në Familje**  
**Telefono numrin: 112 apo 92!**



## Detyrimet e shtetit dhe shoqërisë lidhur me dhunën në familje

### Shteti

Shteti është i detyruar të luftojë dhunën në familje që të mos ndodhë, dhe po qe se ajo ndodh, shteti është i detyruar që t'u ofrojë mbrojtje viktimave të kësaj dhune. Për këtë arsye, shteti ndërmerr të gjitha masat e duhura për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut duke u mundësuar viktimave të dhunës në familje të parashtrajnë kërkesë në gjykatë, duke ofruar shërbime sociale si dhe kujdesin shëndetësor.

Shteti ka përgjegjësi jo vetëm për të ndaluar shkeljen e të drejtave njerëzore të grave, të fëmijëve dhe të çdo personi tjetër viktimë e dhunës në familje, por edhe për marrjen e masave aktive për parandalimin dhe mbrojtjen e këtyre viktimave.

### E dini ç'është mbrojtësi i viktimave?

Mbrojtësi i viktimave është personi i autorizuar zyrtar i cili ndihmon viktimat e dhunës në familje. Mbrojtësit e viktimave luajnë rol aktiv në përfaqësimin e interesave të viktimës. Këta janë përgjegjës që para organeve kompetente të ofrojnë mbrojtje profesionale duke dhënë këshilla, duke iniciuar procedurat për caktimin e masave të mbrojtjes si dhe procedura tjera të nevojshme për të mbrojtur me dinjitet viktimës. Paraprakisht, do të marrë pjesë në të gjitha seancat gjyqësore dhe do t'i kundërshtojë vendimet e gjykatës me ankesë për të gjitha rastet kur pretendon se vendimi është marrë në dëm të viktimës.

**(Neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, pika 1.8 LMDHF)**

### Zyrat regjionale të DMNV-së dhe informatat kontaktuese me mbrojtësit e viktimave

#### Nr. i telefonit kujdestar 24 orë i hapur

#### Lista e numrave kujdestarë funksionalë të zyrave regjionale të MV-ve

<b>Regjioni i Prishtinës:</b>	<b>044 278 738;</b>
<b>Regjioni i Gjilanit:</b>	<b>044 310 467;</b>
(Kamenicë, Viti)	
Nënregjioni i Ferizajt:	<b>044 161 138;</b>
<b>Regjioni i Prizrenit:</b>	<b>044 310 468;</b>
Nënregjioni i Malishevës:	<b>044 418 657,;</b>
Nënregjioni i Suharekës:	<b>044 425-480, 044 310 468;</b>
<b>Regjioni i Pejës:</b>	<b>044 348 164;</b>
Nënregjioni i Gjakovës:	<b>044 418 668;</b>
Nënregjioni i Deçanit:	<b>044 425 469;</b>
Nënregjioni i Istogut:	<b>044 352 938;</b>
<b>Regjioni i Mitrovicës:</b>	<b>044 310 466, 044 425 479.</b>

## Policia

Viktimat e dhunës në familje duhet që të kontaktojnë me punonjësit e policisë në kohën sa më të shkurtër kur është paraqitur dhuna në familje. Policia luan një rol të rëndësishëm në krijimin e besimit dhe të bashkëpunimit të ndërsjellë me viktimën e dhunës. Viktima duhet të kërkojë nga policia informata për strehimoret dhe për masat tjera për mbrojtjen e tyre.

### A e dini çfarë mund të bëjë policia e Kosovës për ju, nëse jeni viktimë e dhunës në familje?

- Policia do të veprojë me urgjencë kur ka dhunë në familje dhe do t'i ndërmarrë të gjitha masat për dërgimin në vendin e ngjarjes të grupit hetimor për kryerjen e veprimeve procedurale;
- Viktima e dhunës në familje mund të kërkojë që të japë deklaratën tek zyrtarja e policisë së gjinisë femëore me qëllim që të ndihet më e lirë;
- Do të përpilojë raportin policor lidhur me rastin;
- Do të bëjë sigurimin e transportimit të viktimës dhe fëmijëve të saj deri në objektin e duhur mjekësor për trajtim ose kontrollim mjekësor;
- Do të japë informata lidhur me shërbimet e ndihmës ligjore, psikologjike dhe ndihmave të tjera në dispozicion nga institucionet qeveritare si dhe prej rrjetit të autorizuar të organizatave joqeveritare, të cilat ofrojnë shërbime për viktimat;
- Ata do të bëjnë fotografimin e plagëve dhe do të mbledhin prova të cilat do të përdoren në gjykatë;
- Do të bëjë kallxim penal nëse dhuna e shkaktuar ka pasoja të veprës penale dhe do të informojë prokurorin menjëherë për rastin.

Policia është në shërbim të qytetarëve.



Zyrtari policor është i autorizuar ta ndalojë personin atëherë kur është e nevojshme:

- Ta mbrojë personin nga rreziku dhe dëmi, veçanërisht kur personi s'ka mundësi për t'u mbrojtur.



(Neni 10 i Ligjit për Policinë e Kosovës)

## **Policia e Kosovës mund të lëshojë urdhër për mbrojtjen e përkohshme emergjente**

Jashtë orarit të punës së gjykatave, sipas kërkesës shefi i njësitit rajonal të Policisë së Kosovës mund të shqiptojë urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente kundër kryerësit të dhunës në familje, në rastet kur:

- Ekzistojnë baza për të besuar se kryerësi ka kryer ose është kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje;
- Atëherë kur kryerësi i dhunës paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të atypëratyshëm për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare.

Shqiptimi i urdhrin lëshohet për të siguruar shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, e që duhet të mbrohet me anë të urdhrin për mbrojtje.

Urdhri i shqiptuar kundër dhunës në familje hyn në fuqi menjëherë dhe i dërgohet kryerësit të dhunës në familje, palës së mbrojtur, kërkuesit dhe personave të tjerë, emrat e të cilëve janë shënuar në urdhrin për mbrojtje emergjente.

Njëkohësisht, urdhri i dërgohet stacionit lokal të policisë në vendbanimin ose vendqëndrimin e palës së mbrojtur dhe personave të tjerë të përmendur në urdhër, qendrës për punë sociale në komunën ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin pala e mbrojtur dhe personat e tjerë të përmendur në urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente, gjykatës kompetente komunale, mbrojtësit të viktimave.

Urdhri përmban njoftimin se kryerësit të dhunës mund t'i ofrojë ndihmë përfaqësuesi ligjor në procedurën ligjore me shpjegimin se pas kalimit të afatit për mbrojtje të përkohshme emergjente, pala e mbrojtur mund të paraqesë kërkesë për urdhër mbrojtje emergjente, e cila nëse lejohet, do t'i nënshtrohet mbajtjes së një seance apo paraqitjes së kërkesës për urdhër mbrojtje kundër së cilës ushtrohet ankesë.

Shkelja e urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente është vepër penale.

Urdhrit për mbrojtje të përkohshme emergjente i skadon efekti në fund të ditës së ardhshme gjatë së cilës gjykata punon.

**(Neni 23-26 LMDHF)**



## Zyrat për ndihmë juridike në Kosovë


**BQNJ - Prishtinë/ Rr. "Zenel Salihu",  
Nr. 30**  
tel:+381(0)38 200/18-945

**BQNJ - Prizren/  
Rr. "Marin Barleti", ish objekti i  
Kadastrit**  
tel:+381(0)29/230554

**BQNJ - Pejë/Rr. „Bukuroshes” Nr. 8**  
tel:+381(0)39/ 423-698

**BQNJ - Mitrovicë/ Rr."Vëllezërit  
Dragaj", Nr. 16**  
tel:+381(0)28/534-477

**BQNJ - Gjilan/ Rr. "Mulla Idrizi"  
Nr. 41**  
tel:+381(0)280/321-134



Nëse jeni viktimë e dhunës në familje, ti ke nevojë për ndihmë juridike. Kontakto njërën nga këto zyra! Zyrat janë të gatshme për të ofruar shërbime profesionale për mbrojtjen sa më efikase të të drejtave tua.

Ndihma juridike e dhënë nga këto zyra është falas, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive dhe të barabartë në drejtësi.

## Gjykata

### Inicimi i procesit gjyqësor kur ka dhunë në familje

#### Kërkesa

Viktima e dhunës në familje ka të drejtë të bëjë kërkesë në gjykatë për të gjitha rastet kur kundër saj është ushtruar dhunë. Kërkesën viktima e paraqet në Gjykatën Komunale, ku viktima ka vendbanimin apo vendqëndrimin.

#### Kërkesa përmban:

- Emërtimin e gjykatës, emrin, adresën dhe profesionin e kërkuarit dhe të kryerësit të dhunës në familje;
- Emrin dhe adresën e palës së mbrojtur dhe të personit i cili ka dhunë, si dhe kërkuar mbrojtjen për palën ndaj së cilës është ushtruar dhuna, si dhe lidhja familjare e palës me personin i cili ka shkaktuar dhunë në familje;
- Përshkrimi i gjendjes faktike dhe bashkëngjitja e provave;
- Nëse zbulimi i vendbanimit apo vendqëndrimit të kërkuarit, të palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, e i cili duhet të mbrohet me anë të urdhrit për mbrojtje ose urdhrit për mbrojtje emergjente, do ta rrezikonte atë person, atëherë mund të merren një apo më tepër veprime, si më poshtë:
- Kërkesa duhet të sigurojë një adresë alternative;
- Nëse gjykata vendos se zbulimi i adresës në dosjet e gjykatës është i domosdoshëm, ato dosje në të cilat shkruhet adresa duhet të jenë të mbyllura.
- **(Neni 14 i LMDHF)**


Çdokush ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës. Gjykata funksionon për të mbrojtur qytetarët. Mos hesht!



## **Kush mund ta paraqesë kërkesën për urdhër mbrojtje dhe urdhër për mbrojtje emergjente?**

- Pala e mbrojtur;
- Përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur;
- Mbrojtësi i viktimave me pëlqimin e palës së mbrojtur;
- Përfaqësuesi i qendrës për punë sociale në komunën ku pala e mbrojtur ka vendbanimin apo vendqëndrimin në rastet kur viktimë është i mituri;
- Personi me të cilën pala e mbrojtur ka lidhje familjare;
- Personi i cili është në dijeni të drejtpërdrejtë për një apo më tepër vepra të dhunës në familje ndaj palës së mbrojtur;
- Kërkesë për urdhër mbrojtje ose për urdhër mbrojtje emergjente mund të paraqesin edhe OJQ-të, që janë familjarizuar me problemin e viktimës, që janë njoftuar mirë për trajtimin e tyre.

**(Neni 13 i LMDHF)**



## **Gjykata do ta shqyrtojë kërkesën me efikasitet dhe drejt**

Gjykatat krijohen dhe ekzistojnë që të mbrojnë të gjithë qytetarët, në mënyrë të barabartë, pa paragjykitje apo diskriminim. Funkzioni i gjykatës është sigurimi dhe mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Gjykatat janë në dispozicion të të gjithë personave, pa marrë parasysh dallimet gjinore, etnike, fetare apo statusi tjetër. Këto ju sigurojnë qasje të barabartë për të gjithë qytetarët dhe askush nuk duhet të pengohet apo të privohet nga kjo e drejtë.

Kjo vepron me efikasitet dhe me profesionalizëm duke e marrë seriozisht çështjet të cilat janë në kompetencë të saj. Andaj, gjykata përmes procedurave formale dhe joformale do të jenë të shpejta, korrekte, ekonomike dhe të zbatueshme në praktikë.

## Urdhri për mbrojtje të përkohshme emergjente që shqipton gjykata

Gjykata vendos përkitazi me kërkesën për urdhër mbrojtje emergjente brenda 24 orëve, pas parashtrimit të kërkesës. Me rastin e shqyrtimit të kërkesës, gjykata mban seancë gjyqësore të mbyllur në të cilën seancë janë të pranishëm:

- Pala e mbrojtur;
- Përfaqësuesi i autorizuar ose mbrojtësi i viktimave;
- Kryerësi i dhunës ose përfaqësuesi i autorizuar;
- Parashtruesi i kërkesës;
- Çdo dëshmitar, i cili ka njohuri për dhunën në familje.



Gjykata gëzon autoritetin që të shqiptojë urdhrin në mungesë të kryerësit të dhunës në familje, duke shfrytëzuar dhe mjetet tjera alternative, përfshirë ato elektronike.

Kur gjykata gjen se kërkesa është e bazuar merr **aktvendim për urdhrin për mbrojtje emergjente**, në të cilën shqiptohen edhe masat mbrojtëse, varësisht nga rasti.

Kohëzgjatja e urdhrin për mbrojtje emergjente skadon në fund të dëgjimit për vërtetimin e urdhrin për mbrojtje emergjente, e cila duhet të jetë brenda tetë ditëve, prej shqiptimit të urdhrin dhe njoftimi se kryerësit mund t'i ofrojë ndihmë përfaqësuesi i autorizuar.

Gjykata gjatë dëgjimit, për vërtetimin e urdhrin, mund të jepë urdhrin për përfundimin e urdhrin për mbrojtje emergjente, ose të shqiptojë urdhrin për mbrojtje.

Vendimi për urdhër mbrojtje emergjente ekzekutohet menjëherë, me vendim përkatës, i shqiptuar nga gjykata kompetente dhe iu dërgohet menjëherë kryerësit të dhunës në familje, Policisë së Kosovës, Qendrës për Punë Sociale, si dhe palëve të tjera në procedurë. Kundër vendimit të urdhrin për mbrojtje emergjente, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej tri ditësh, nga dita e dorëzimit të vendimit. Parashtrimi i ankesës nuk e ndalon ekzekutimin e urdhrin për mbrojtje emergjente.

Në urdhër ceket se moszbatimi i tij është vepër penale. Dy ditë, para skadimit të urdhrin për mbrojtje emergjente, pala e mbrojtur, përfaqësuesi i autorizuar ose mbrojtësi i viktimave mund të parashtrorjë kërkesën për vazhdimin e urdhrin për mbrojtje emergjente, për të cilën gjykata vendos ta vazhdojë apo ndërpresë urdhrin. Në rast se nuk paraqitet kërkesa urdhri ndërpritet menjëherë.

**(Neni 16,-22 i LMDHF)**



## Urdhri për mbrojtje

Gjykata kompetente në procedurën kontestimore vendos me **aktvendim** përkitazi me kërkesën për urdhër mbrojtje, brenda pesëmbëdhjetë ditëve pas pranimi të saj. Gjykata shqipton urdhër mbrojtjen në rastet kur dyshon se kryerësi i dhunës pashmangshëm rrezikon sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur dhe personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare dhe i cili duhet të mbrohet me anë të urdhër mbrojtjes.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtje, gjykata e mban seancën e dëgjimit në mënyrë që t'i dëgjojë personat në vijim:

- Pala e mbrojtur;
- Përfaqësuesin e autorizuar ose mbrojtësi i viktimave;
- Kryerësi i dhunës ose përfaqësuesi i autorizuar;
- Parashtruesi i kërkesës;
- Përfaqësuesin nga qendra për punë sociale i komunës në të cilin jeton përherë ose përkohësisht për rastet kur parashtruesi i kërkesës është i moshës nën tetëmbëdhjetë vjeç ose i mungon zotësia e veprimit ose veprat e supozuara të dhunës në familje kanë ndikim në personin i cili është i moshës nën tetëmbëdhjetë vjeç ose nuk ka zotësi të veprimit;
- Dëshmitarë të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.

Dëgjimi dhe shqiptimi bëhet në mungesë të kryerësit të dhunës në familje nëse kryerësi i dhunës në familje është thirrur në mënyrë të rregullt dhe nëse kërkesa është mbështetur në dëshmi të mjaftueshme.

Kërkesa konsiderohet si e tërhequr nëse në seancën e dëgjimit nuk paraqiten as pala e mbrojtur e as përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur dhe nëse këta individë janë thirrur në mënyrë të rregullt, ndërsa nuk e kanë njoftuar gjykatën për arsyet e mungesës së tyre. Tërheqja e kërkesës nuk parandalon paraqitjen e kërkesës tjetër.

Pesëmbëdhjetë ditë para skadimit të urdhrit për mbrojtje, pala e mbrojtur ose përfaqësuesi i autorizuar, mund të parashtrorë kërkesën për vazhdimin e urdhrit për mbrojtje, nëse kanë ndryshuar rrethanat gjykata mund të vendosë që urdhri për mbrojtje, të mbetet në fuqi, të ndryshohet apo të ndërpritet. Nëse nuk parashtrorë kërkesa për vazhdimin e urdhrit për mbrojtje, ai ndërpritet menjëherë në ditën e skadimit.

Kundër vendimit të urdhrit për mbrojtje, mund të ushtrohet ankesë, brenda afatit tetë ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit. Moszbatimi i urdhrit për mbrojtje është vepër penale.

Kohëzgjatja e urdhrit për mbrojtje nuk mund të jetë më e gjatë se dymbëdhjetë muaj, por me mundësi vazhdimi jo më shumë se njëzet e katër muaj.

**(Neni 18-20 i LMDHF)**

## **Gjykata bashkë me njërin nga urdhrat mund të shqiptojë një apo më shumë nga masat**

- Masa e trajtimit psikosocial i shqiptohet kryerësit në kombinim me ndonjë masë tjetër parandaluese, me qëllim të evitimit të sjelljeve të dhunshme apo për rastet nëse ekziston rrezik i përsëritjes së dhunës në familje. Kjo masë zgjat derisa të përfundojnë shkaqet mbi bazën e të cilave është shqiptuar, por nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtë muaj;
- Masa e ndalimit të afrimit viktimës së dhunës në familje, gjykata me këtë masë cakton vendin, regionin dhe largësinë, brenda së cilës kryerësi nuk guxon t'i afrohet viktimës së dhunës në familje;
- Masa e ndalimit të shqetësimit personave të ekspozuar dhunës shqiptohet nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje. Me këtë masë kujdestaria e fëmijës përkohësisht i besohet viktimës së dhunës në familje, ndërsa e drejta prindërore përkohësisht i hiqet kryerësit të dhunës në familje;
- Masa e largimit nga banesa, shtëpia apo hapësira tjetër e banimit. Personi të cilit i është shqiptuar masa obligohet menjëherë t'a lëshoj banesën, shtëpinë apo hapësirën tjetër të banimit, në prezencë të zyrtarit policor;
- Masa mbrojtëse e shoqërimit viktimës së dhunës i shqiptohet me qëllim të mbrojtjes gjatë marrjes së gjësendeve personale;
- Masa mbrojtëse e trajtimit mjekësor nga varësia prej alkoolit dhe substancave psikotrope i shqiptohet kryerësit, i cili ka kryer dhunë në familje nën ndikimin e tyre, kur ekziston rreziku i përsëritjes;
- Masa mbrojtëse e marrjes së sendit i shqiptohet me qëllim të mbrojtjes së personit ndaj të cilit është ushtruar dhuna në familje apo e personave të tjerë;
- Masat mbrojtëse pasurore urdhërimi i kryerësit të dhunës në familje që të lejojë palën e mbrojtur të shfrytëzojë banesën të cilën e përdorin së bashku ose ndonjë pjesë të saj, po ashtu mund të urdhërohet që të paguajë qiranë e banesës së përkohshme, apo paguajë alimentacionin dhe obligime tjera sipas vlerësimit të gjykatës.

**(Neni 4-11 i LMDHF)**

## Veprimet e prokurorit publik kur nga dhuna në familje është kryer vepër penale

Shqiptimi i cilitdo urdhër, me vendim gjykate, nuk i ndalon palët e interesuara të nisin procedurë penale, për sa i përket veprimeve dhe mosveprimeve që përbëjnë veprat penale. Detyra e prokurorit shtrihet jo vetëm në ushtrimin e ndjekjes penale për këto raste, si një funksion kushtetues dhe ligjor që lidhet me ndëshkimin e kryerësit të një vepre penale por edhe në goditjen me të gjithë forcën e ligjit të një fenomen aq të dëmshme për familjen dhe shoqërinë, siç është ai i dhunës në familje.

Roli parësor i prokurorit është mbrojtja e të drejtave të viktimave si dhe ushtrimi me efikasitet i ndjekjes penale duke ngritur aktakuzë dhe përfaqësimi i saj para gjykatës në të gjitha rastet kur nga dhuna në familje ka ardhur një pasojë në shëndetin e viktimës, pasojë e cila determinon edhe veprën penale konkrete, e cila mund të jetë sipas rastit, dëmtim i shëndetit apo i jetës së individit nëpërmjet veprave penale, të cilat janë të sanksionuara me Kodin Penal të Kosovës, siç janë:

- Vrasja (neni 146), vrasja e rëndë neni (147), vrasja e kryer në gjendje të afektit mendor (neni 148), vrasja nga pakujdesia (neni 149), vrasja e foshnjeve gjatë lindjes (neni 150), shtytja në vetëvrasje dhe dhënia e ndihmës në vetëvrasje (neni 151), ndërprerja e palejuar e shtatzënisë (neni 152).
- Lëndimi i lehtë dhe i rëndë trupor, (neni 153 dhe 154 i KPK-së;
- Shtrëngimi (neni 160);
- Kanosja (neni 161);
- Privimi i kundërligjshëm nga liria, (neni 162 paragrafi 4);
- Dhunimi, përfshirë dhunimin martesor dhe sulmin seksual (neni 193, 194, 195);
- Degradimi i integritetit seksual (neni 196);
- Keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime mendore a emocionale ose me paaftësi mendore (neni 197);
- Rrëmbimi i kundërligjshëm i fëmijës (neni 210);
- Keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës (neni 211);
- Shkelja e detyrimeve familjare (nenet 212, 213);
- Vendosja e skllavërisë, kushteve të ngjashme me skllavërinë dhe e punës së detyruar (neni 137); dhe
- Veprat penale kundër pasurisë kur kryhen në lidhje familjare, përfshirë veprat penale të vjedhjes, shpërdorimi ose marrja e posedimit të pasurisë së luajtshme të viktimës, përfshirë mashtrimin, sikurse dhe dëmet e shkaktuara në të drejtat pronësore (nenet 252, 253, 257, 258, 260).



## **Mekanizmat shtetërorë dhe joqeveritarë në Republikën e Kosovës që përkujdesen për mirëqenien e grave dhe fëmijëve**

### **Kuvendi i Republikës së Kosovës**

- Grupi Joformal i Grave Parlamentare;
- Komisioni Parlamentar për Liri dhe të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione.

### **Qeveria e Republikës së Kosovës**

- Agjencia për Barazi Gjinore / Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- Institucioni i Ombudspersonit - Njësia për Barazi Gjinore;
- Zyrtarët për Barazi Gjinore në Ministri;
- Këshilli Ndër-ministoror për Barazi Gjinore;
- Sektori për çështje gjinore - MAPL.

### **Mekanizmat në nivelin lokal**

- Zyrtarët për Barazi Gjinore në Komuna;
- Komitetet Komunale për Barazi Gjinore.

### **Mekanizmat joqeveritare**

- Organizatat jo-qeveritare;
- Strehimoret (në gjashtë qytete).

### **Mekanizmat qeveritarë që trajtojnë dhunën në familje**

- Njësiti i Dhunës në Familje - Shërbimi Policor i Kosovës;
- Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave - Ministria e Drejtësisë;
- Qendrat për Punë Sociale - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- Strehimorja.

### **Institucionet shtetërore**

- Policia
- Prokuroritë
- Gjykatat

**Vëni re!** OSBE-ja do të publikojë një informator me shënime të nevojshme për viktimat e dhunës në familje, e cila do të përmbajë listën e institucioneve dhe telefonat kontaktues. Ky informator do të shpërndahet në gjykata dhe institucionet tjera relevante në fund të vitit 2011.

**Informatat për kontaktim të ombudspersonit  
(Avokati i popullit)**

**Zyra Qendrore Prishtinë**

Adresa: Lagjja Bregu i Diellit „Enver Maloku” nr.28  
Tel: +381 (0) 38 501 401,  
Faks: +381 (0) 38 /545 302 038 223 780, 038 548 087  
Puna me palë: Nga e hëna deri të enjten, 10.00 -14.00

**Zyra e Terrenit Graçanicë**

Adresa: Rruga kryesore, përballë Manastirit  
Tel: +381 (0) 38 65 118  
Tel. mobil: +381 (0) 64 37 111 37 / 044/367-719  
Puna me palë: E hënë dhe e enjte, 10.00 – 14.00

**Zyra e Terrenit Gjilan**

Adresa: Rr.”Adem Jashari”, Objekti i Komunës II  
Tel: +381 (0) 280/ 320 843  
Puna me palë: E hënë dhe e enjte, 10.00 – 14.00

**Zyra e Terrenit Prizren**

Adresa: Rr. “Remzi Ademi”, Qendra Rajonale e OSBE-së ZR,  
II, Nr. 20  
Tel: +381 (0) 29 /44 200 lok. 109, +381 (0) 29 222 138  
Puna me palë: E hënë dhe e mërkurë, 10.00 – 14.00

**Zyra e Terrenit Pejë**

Adresa: Rr. “Mbretëresha Teutë”, Nr . 59, Objekti i Komunës, kati 3  
nr. 3  
Tel: +381 (0) 39 /432 931  
Pranimi i palëve: E hënë dhe e enjte, 10.00 – 14.00

**Zyra e Terrenit Mitrovicë**

Adresa: Sheshi “Agim Hajrizi”, Objekti i Administratës Tatimore  
Rajonale  
Tel: +381 (0) 28 530 138  
Puna me palë: E hënë dhe e enjte, 10.00 – 14.00  
Nën-zyra e Terrenit Mitrovicë  
Adresa: Aneksi i Trepçës, Filipa Visnjica” 4  
Tel: +381 (0) 63 817 44 79, +377 (0) 44 393 181  
Puna me palë: E hënë dhe e enjte, 10.00 – 14.00

**Nëse keni nevojë  
për ndihmë  
për realizimin e të  
drejtave tuaja ,  
keni të drejtë të  
kontaktoni njërën  
nga këto zyra  
Avokati i Popullit  
është në shërbim  
të të gjithë  
qytetarëve pa  
dallim gjinie, feje,  
kulture, etnie apo  
të çdo dallimi  
tjetër, ky ka  
instrumentet e  
nevojshme ligjore  
që t’ju  
dalë në ndihmë.  
MOS HEZITO,  
KONTAKTO!**

Web faqja: <http://www.omudspersonkosovo.org> (në gjuhën shqipe, serbe dhe turke)

## KONKLUZIONE

Dhuna në familje është krim. Andaj, e rëndësishme është që të raportohet dhe të iniciohet procedura në gjykatë. Për të luftuar dhunën në familje, posaçërisht dhunën ndaj gruas dhe fëmijëve, duhet të forcohet bashkëpunimi midis organeve shtetërore dhe organizatave joqeveritare.

Me qëllim që të zvogëlohet numri i rasteve të dhunës në familje në Kosovë, është e nevojshme të krijohet një vizion i përbashkët që do të na çonte në veprime të përbashkëta. Kosova duhet të vazhdojë të investojë mjete dhe të vazhdojë të trajtojë gjyqtarët dhe prokurorët dhe akterët tjerë, me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të viktimave të dhunës në familje.

Andaj, nevojitet një sensibilizim i të gjithë mekanizmave dhe akterëve relevantë nga kjo fushë pasi që dhuna në familje është një problem që prek të gjitha shtresat dhe grupet e shoqërisë, pa dallim race, gjinie, etnie, niveli ekonomik, zone gjeografike, besimi fetar, moshe, etj.

### **Viktimat e dhunës në familje duhet të dinë se:**

- Kosova ka Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;
- Ligji ju garanton mbrojtësin e viktimave;
- Policia ka njësit të posaçëm që mbron viktimat e dhunës në familje;
- Prokurorët janë të obliguar në bazë të ligjit të ngrisin akuzë kur ka prova se ka vepër penale si pasojë e dhunës në familje;
- Gjykata do të trajtojë dhunën në familje pa diskriminim dhe me efikasitet;
- Ekzistojnë organe, organizata joqeveritare dhe strehimore që i mbështesin viktimat e dhunës në familje.

## **BURIMET :**

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

Konventa Ndërkombëtare për të drejta civile dhe politike;

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut ;

Karta Sociale Evropiane;

Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës, të Trajtimeve ose Ndëshkimeve Çnjerëzore dhe Poshtëruese;

Konventa “Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave” (CEDAW);

Rekomandimi Rec (2002) 5 i Komitetit të Ministrave;

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës;

Konventa për Dhunën në Familje;

Kushtetuta e Republikës së Kosovës;

Ligji për Familjen i Kosovës, (Ligji nr. 2004/32);

Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (Ligji Nr. 03/L-182);

Ligji për Barazinë Gjinore, (Ligji Nr. 2004/02);

Ligjit për Policinë e Kosovës, (Ligji Nr. 03/L-035);

Kodi Penal i Kosovës.

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

343.55(496.51)(035)

Dhuna në familje qështje jete : udhërrfyes për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje / përgatitur nga Ramadan Gashi, Lumnije Krasniqi, Mary Shahin. - Prishtinë : Instituti Gjyqësor i Kosovës, 2011. - 39 f. : ilustr. ; 24 cm.

Parathënie : f. 5. - Burimet : f. 38

1. Gashi, Ramadan
2. Krasniqi, Lumnije
3. Avirre-Shahin, Mary

**ISBN 978-9951-557-02-3**



Rr. "Muharrem Fejza"  
Prishtinë, Kosovë  
<http://igjk.rks-gov.net>